VENDIM
Nr.2, datë 5.2.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,		
Fehmi Abdiu	anëtar i	“	“
Kristofor Peçi	anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	anëtar i	“	“
Kujtim Puto	anëtar i	“	“
Petrit Plloçi	anëtar i	“	“
Sokol Sadushi	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Gjergji Sauli	anëtar i	“	“

me sekretare Brunilda Bara, në datë 25.9.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.44/2 Akti, që i përket:

KËRKUES: MYZEJEN BARDHOSHI (KARAPICI), ARJAN KARAPICI, RASIM KARAPICI, përfaqësuar nga avokatët Eno Bushi dhe Dhimitër Muslia, me prokurë.

SUBJEKTE TE INTERESUARA:

AFRIM VIGANI, AGRON ZALA, përfaqësuar nga avokat Viktor Ikonomi, me prokurë.

ISMAIL NELAJ, FORTUZ NELAJ, përfaqësuar nga avokatët Bashkim Merkaj dhe Brahim Lahi, me prokurë.

RASIM NELAJ, FITNETE NELAJ, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.838, datë 27.6.2006.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f, 131/1, 134/1, shkronja “g” dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Kërkuesit, për shfuqizimin e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Lartë, kanë parashtruar këto shkaqe:

- gjykimi i çështjes në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë është zhvilluar në seancë plenare në mungesë të tyre, në një kohë që, në bazë të nenit 447 të Kodit të Procedurës Civile, duhet të thirreshin për të marrë pjesë në gjykim;
- kërkesa për rishikim është paraqitur brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 496 i Kodit të Procedurës Civile.

Subjektet e interesuara:

Afrim Vigani dhe Agron Zala kërkuan shfuqizimin e vendimit të mësipërm të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, pasi gjatë procesit gjyqësor nuk u administruan dhe vlerësuan provat e paraqituara për falsifikimin e dokumenteve të pronësisë.

Ismail Nelaj dhe Fortuz Nelaj u shprehën për mospranimin e kërkesës sepse:

- kërkuesit kanë marrë dijeni për kërkesën e rishikimit dhe për datën e gjykimit të çështjes nëpërmjet përfaqësimit nga avokat Viktor Ikonomi;
- kërkuesit kanë të drejtë për të paraqitur kërkesë për rishikim në Gjykatën e Lartë, edhe pse një të drejtë të tillë e kanë ushtruar subjektet e interesuara Afrim Vigani dhe Agron Zala.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gjergji Sauli, përfaqësuesin e kërkuesit që kërkoi pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimin nr.167, datë 30.9.1997 të K.K.K.Pronave pranë Bashkisë Tiranë, kërkuesit janë kompensuar si ish-pronarë me një sipërfaqe trualli prej 645 m^2 në ish-pronën e subjekteve të interesuara Xhevdet Nelaj etj., në pjesën e tyre të pakthyer prej 11325 m^2. Kërkuesit, truallin e mësipërm me sipërfaqe prej 645 m^2, ua kanë shitur subjekteve të interesuara Afrim Vigani dhe Agron Zala me kontratën noteriale nr.975/328, datë 25.11.1997.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pas shqyrtimit të kërkesëpadisë së ngritur prej subjekteve të interesuara Xhevdet Nelaj etj., me vendimin nr.1454, datë 10.4.2002 ka anuluar vendimin nr.167, datë 30.9.1997 të K.K.K.Pronave të Bashkisë Tiranë, si dhe ka deklaruar pavlefshmërinë e kontratës së shitblerjes nr.975/328, datë 25.11.1997, për sipërfaqen e truallit prej 645 m^2.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.619, datë 15.5.2003 ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit dhe ka rrëzuar kërkesëpadinë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi ankimin e subjekteve të interesuara Xhevdet Nelaj etj., me vendimin nr.1894, datë 7.10.2004 ka prishur vendimin nr.619, datë 15.5.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe ka lënë në fuqi vendimin nr.1454, datë 10.4.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Subjektet e interesuara Afrim Vigani dhe Agron Zala kanë bërë kërkesë për rishikim kundër vendimit të mësipërm të Gjykatës së Lartë. Si shkak i kërkesës për rishikim u paraqit vendimi penal nr.348, datë 8.4.2004 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin subjekti i interesuar Rasim Nelaj është deklaruar fajtor në bazë të nenit 186/1 të Kodit Penal për falsifikim të dokumenteve të pronësisë së truallit me sipërfaqe prej 645 m2, vendim i cili është lënë në fuqi në të gjitha shkallët e gjykimit.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi ka kaluar çështjen për shqyrtim në seancë plenare, me vendimin nr.838, datë 27.6.2006 ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim me arsyetimin, se kërkuesit nuk kanë paraqitur asnjë provë për të vërtetuar se kur kanë marrë dijeni për vendimin penal të lartpërmendur dhe se atyre u ka kaluar afati 30 ditor i paraqitjes së kërkesës, që sipas nenit 496 të Kodit të Procedurës Civile fillon nga data kur vendimi ka marrë formë të prerë.

Kërkuesit pretendojnë se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, kërkesën për rishikimin e vendimit të mësipërm e ka shqyrtuar padrejtësisht në mungesë të tyre pa i thirrur ata për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes. Këtë fakt kërkuesit e quajnë shkak të rëndësishëm për deklarimin e vendimit si antikushtetues duke e bërë procesin jo të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Gjykata Kushtetuese çmon se për çështjen në gjykim, me objekt rishikim vendimi, mosthirrja në këtë rast e kërkuesve për të marrë pjesë në gjykim nuk e bën procesin gjyqësor të parregullt në kuptimin kushtetues.

Sipas nenit 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, e drejta për të paraqitur kërkesë në Gjykatën e Lartë për rishikimin e një vendimi të formës së prerë, i përket në mënyrë të pavarur çdo personi që ka qenë palë në gjykimin e çështjes, për të cilën është dhënë vendimi dhe që ka interes të ligjshëm për rishikimin e tij. Kjo do të thotë se është në vullnetin e personit të mësipërm që të paraqesë ose jo kërkesën për rishikim, ose ta paraqesë atë së bashku me persona të tjerë që janë palë në të njëjtën çështje.

Gjatë gjykimit të çështjes Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkuesit nuk kanë paraqitur ndonjë kërkesë të veçantë në Gjykatën e Lartë për rishikimin e vendimit dhe as nuk kanë ndërhyrë gjatë procesit gjyqësor për t'u bashkuar me kërkesën për rishikim, të paraqitur prej subjekteve të interesuara Afrim Vigani dhe Agron Zala. Gjithashtu, kërkuesit, në kërkesën e paraqitur për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, nuk përmendën ndonjë shkak të ri ose të ndryshëm nga shkaqet e paraqitura nga subjektet e interesuara të mësipërme. Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese çmon se kërkesa e paraqitur nga kërkuesit për shfuqizimin e vendimit si rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor, duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f dhe 134/1 germa "g" të Kushtetutës, si dhe nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren

Zyrtare.

Kryetar: V. Kristo
Anëtarë: K. Peçi, S. Sadushi, P. Plloçi, Xh. Zaganjori, K. Puto
Anëtarë kundër: F. Abdiu, Gj. Sauli, S. Berberi